

Statuti

Ky statut do të qeverisë shoqatën jo-profitabile Rrjetin “FORUMI KULTUROR I KOSOVËS”, të themeluar në pajtim me Ligjin numër 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

- 1.1. Organizata do të quhet :
“Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës - Forumi Kulturor i Kosovës ”
- 1.2. Ajo mund të njihet edhe si: **Forum i Kulturor i Kosovës - FKK**
- 1.3. Organizata është shoqatë jo-profitabile, sipas definimit të dhënë në nenin 5.2 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-57 Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.
- 1.4. Organizata nuk do të bëjë shpërndarjen e çfarëdo fitimi neto ose të profitit si të tillë për asnjë individ. Pasuria, të ardhurat dhe profiti i organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet joprofitabile të organizatës dhe nuk do të përdoren për të krijuar beneficione të veçanta individuale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte në asnjërin nga themeluesit, drejtorin, nëpunësin, ndonjë anëtar të shoqatës, ndonjë të punësuar apo donator të OJQ-së. Megjithatë pagesa e kompensimit të arsyeshëm për këta persona mund të bëhet për punën që këta persona kanë bërë për këtë organizatë.
- 1.5. Ndonjë transaksion në mes të anëtarëve, anëtarëve të kryesisë, personi ose nëpunësi dhe organizatës duhet të mbyllet në vlera reale të tregut ose në kushte që janë më të favorshme për organizatën.
- 1.6. Organizata e ka zyrën e saj qendrore në Pallatin e Rinisë, Kulturës dhe Sportit, nr. 111 në Prishtinë.

Neni 2 **Themeluesit**

2.1. Themelues të organizatës janë:

- Lirak Çelaj, Teatri ODA, Pallati i Rinise, Kultures dhe Sportit, H/ 111, Prishtinë
- Eroll Shporta, Doku Fest, Mimar Sinan 12, Prizren
- Hajrulla Çeko, Ec Ma Ndryshe, Ismet J. Kumanova N31, Prizren

2.2. Përfaqësues i autorizuar i organizatës në Kosovë dhe jashtë saj është Kryetari i Rrjetit,

- Florent Mehmeti, Bregu i diellit, Zona lindje 14/14, 10000 Prishtinë, Kosovë

2.3. Përfaqësuesi i autorizuar emërohet nga Kuvendi i Anëtarëve dhe duhet të përfaqësojë organizatën në Kosovë dhe jashtë saj, pranojë të gjitha shkresat zyrtare në emër të organizatës . Ai ose ajo duhet të jetë përgjegjëse për informimin e autoriteteve relevante për çfarëdo ndryshimi në organizatë.

Neni 3 **Qëllimi**

3.1. Organizata është themeluar me qëllim të:

- Krijimit të një rrjeti të organizatave të pavarura kulturore që është i konsoliduar, efikas, funksional, gjithëpërfshirës e i qëndrueshëm dhe që përfaqëson zërin e artikuluar dhe interesat e organizatave të pavarura të kulturës në Kosovë.
- Fuqizimin e organizatave të pavarura kulturore duke i zhvilluar kapacitetet e tyre për realizim e programeve të tyre
- Afirmimin e organizatave anëtare.
- Përfshirjen e FKK në proceset vendimmarrëse
- Rritjes së përkrahjes të skenës së pavarur të kulturës.
- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave anëtare karshi institucioneve relevante të Kosovës dhe jashtë saj.

3.2. Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poshtëshënuara:

- Komunikimin dhe rrjetëzimin e organizatave të pavarura në fushën e kulturës.
- Shkëmbimin dinamik të informacioneve dhe të përvojave.
- Aktivitete të lobimit dhe avokimit
- Trajnime specifike për nevojat e orgnizatave anëtare
- Organizimin e debateve dhe forumeve
- Bashkërenditja e aktiviteteve të përbashkëta artistike dhe kulturore.

Neni 4 **Anëtarësimi**

- 4.1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për organizata të pavarura të Kulturës, të regjistruara në Kosovë që nuk kanë qëllime fitimprurëse dhe që pajtohen me qëllimet e FKK të definuara me statut dhe dokumente tjera zyrtare të organizatës, pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, përkatësinë etnike, religjionin, moshën ose aftësitë fizike të anëtarëve të organizatave.
- 4.2. Kuvendi i anëtarëve do të vendos nëse do të kërkohet pagesa për anëtarësi. Mospagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga organizata
- 4.3. Kuvendi i anëtarëve aprovon pranimin e anëtarëve të rinj.
- 4.4. Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimit e Kuvendit të Anëtarëve në rast të
 - shkeljes së marrëveshjes së marr në Kuvendin e Anëtarëve
 - punës së tij me qëllim të përfitimit personal
 - mospjesëmarrjes në MPV ose MPJ
 - ndonjë veprim që e dëmton reputacionin e organizatës
 - çfarëdo akti tjetër që nuk është në pajtim me statutin, me parimet e punës së organizatës dhe vendimet e marra në Kuvendin e anëtarëve.Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet.
- 4.5. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga Kuvendi i Anëtarëve do të vendoset me 2/3 e anëtarëve prezent apo të përfaqësuar.
- 4.6. Secili anëtarë mund të lajmërojë tërheqjen nga anëtarësia përmes letrës, faksit, postës elektronike apo çfarëdo mënyre tjetër komunikimi drejtuar Kryetarit dhe kryesisë.

Neni 5 **Kuvendi i Anëtarëve**

- 5.1. Kuvendi i Anëtarëve është organi më i lartë qeverisës i organizatës. Ai përbëhet prej të gjithë anëtarëve të organizatës.
- 5.2. Kuvendi i Anëtarëve ka përgjegjësinë më të lartë për politikën dhe çështjet financiare të organizatës.
- 5.3. Përpos kompetencave që ka Kuvendi i Anëtarëve sipas statutit, ai gjithashtu ka edhe këto kompetenca të:
 - Zgjedh dhe shkarkojë kryesisë dhe Kryetarin
 - Apropojë: raportin vjetor, buxhetin, lartësinë e pagesës së anëtarësisë dhe planin vjetor të kryesisë
 - Ndryshimin e statutit të organizatës
 - Shpërbërjen e organizatës
 - Marr vendime të cilat kryesisë dhe Kryetari janë të obliguar t'i zbatojnë.
 - Aprovon rregullore të brendshme bazuar në Statut për çështje të ndryshme.
 - t'i përcaktojë kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi.
 - nxjerr rregullore të brendshme bazuar në statut.Ka të drejtë të themelojë trupa tjerë ndihmës.
- 5.4. Kuvendi i Anëtarëve mund të delegojë ndonjë përgjegjësi të tij te Kryetari dhe kryesisë, ndonjë organ tjetër ose edhe të punësuar të organizatës, me vendimin e së paku dy të tretave të anëtarëve prezent apo të përfaqësuar.

Neni 6 **Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve**

- 6.1. Kuvendi i Anëtarëve do të takohet së paku një herë në vit në Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore (MPV) ku do të vlerësojë dhe aprovojë mjetet, obligimet, shpenzimet e të hyrave dhe programet për vitet e ardhshme.
- 6.2. Mbledhjet e Kuvendit të Anëtarëve i udhëheq Kryetari dhe ndihmohet teknikisht nga Sekretariati.
- 6.3. Kuvendi i Anëtarëve mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen e Përgjithshme të Jashtëzakonshme (MPJ) kurdoherë që kërkohet nga 30% e më shumë e anëtarëve ose nga Kryetari dhe kryesisë. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Sekretariatit, i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë anëtarët, në pajtim me procedurat të shpjeguara në paragrafin 6.4.
- 6.4. Thirrja për mbledhje bëhet nga Kryetari dhe kryesisë dhe dërgohet me letër, fax, email apo çfarëdo mënyre tjetër komunikimi dhe përfshin datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes së bashku me rendin e ditës së Kuvendit dhe i shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku 7 (shtatë) ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.
- 6.5. Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarrja e 30% e anëtarëve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet, atëherë thirret Kuvendi i Ri, i cili merr vendime me shumicë të anëtarëve prezent apo të përfaqësuar pa marrë parasysh numrin.
- 6.6. Secila organizatë anëtare ka një votë në Kuvendin e Anëtarëve.
- 6.7. Secili anëtarë në rast të pamundësisë për të marr pjesë në Mbledhje ka të drejtë të delegoj votën e tij tek ndonjë anëtar tjetër.
- 6.8. Një anëtarë nuk ka të drejtë të përfaqësoj më shumë se një votë të deleguar. Votat e deleguara janë të vlefshme vetëm kur paraprakisht është lajmëruar me shkrim Kryetari dhe kryesisë si dhe anëtari tjetër së paku 3 (tre) ditë para Kuvendit të Anëtarëve.
- 6.9. Vendimet në Kuvendin e Anëtarëve do të merren me shumicën e anëtarëve prezent, përpos në rastet speciale të parapara në këtë Statut.
- 6.10. Secili anëtar i Kuvendit të Anëtarëve mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.
- 6.11. Vendimet e Kuvendit të Anëtarëve duhet të regjistrohen në regjistrin e organizatës me nënshkrimin e Kryetarit dhe Sekretarit të përgjithshëm. Vendimet duhet t'u komunikohen të gjithë anëtarëve.

Neni 7 **Kryesia**

- 7.1. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, kryesia duhet të veprojë çdo herë në pajtim me qëllimin e organizatës.
- 7.2. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, kryesia do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:
 - të propozoj përfaqësuesin e organizatës, të kontrolloj implementimin e qëllimit dhe aktiviteteve të parapara me statut, t'i përcaktoj kompetencat dhe detyrat e çdo përfaqësuesi të cilat duhet të votohen nga kuvendi.
 - të propozoj përfaqësues në kuvend
- 7.3. Kryesia duhet të përbëhet nga kuvendi i anëtarëve. Ata do të zgjidhen individualisht nga Kuvendi i Anëtarëve me shumicë votash. Çdo anëtarë do të shërbejë në kohëzgjatje prej 3

vitesh dhe do të qëndrojë në zyrë derisa anëtari i ri merr postin, ose deri në vdekje, dorëheqje ose shkarkim nga detyra.

- 7.4. Kryesia duhet të ketë së paku 5 (pesë) anëtarë duke përfshirë edhe Kryetarin.
- 7.5. Anëtarët e kryesisë mund të zgjidhen për 2 mandate të njëpasnjëshme.
- 7.6. Anëtarët e kryesisë mund të shkarkohen para përfundimit të mandatit me votat e MPV-së dhe MPJ-së të Kuvendit të Anëtarëve.
- 7.7. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të kryesisë, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh pasardhësin për të shërbyer për kohën e mbetur.
- 7.8. Vendimet në kryesi merren me shumicë.
- 7.9. Kryesia mund të vendos t'i drejtohet për çfarëdo çështje Kuvendit të Anëtarëve për marrje të vendimit.
- 7.10. Kurrfarë pagese ose kompensimi nuk duhet t'u bëhet anëtarëve të kryesisë pa aprovimin e Kuvendit të Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe bëhet për punën e kryer për organizatë.
- 7.11. Secili anëtar i kryesisë mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimit në çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.
- 7.12 Kryesia duhet të takohet së paku 4 herë në vit.

Neni 8

Kryetari

- 8.1. Kryetari zgjidhet me shumice votash nga Kuvendi i Anëtarëve.
- 8.2. Kryetari zgjidhet me mandat 3 vjeçar me mundësi zgjedhjeje edhe për një tjetër mandat.
- 8.3. Kryetari është automatikisht anëtar i Kryesisë.
- 8.4. Kryetari udhëheqë mbledhjen e Kryesisë dhe atë të Kuvendit.
- 8.5. Përfaqëson FKK-në në Kosovë dhe jashtë saj.
- 8.6. Mbikëqyrë dhe udhëheq punën e sekretariatit.
- 8.7. Së paku njëherë në vit raporton para kryesisë dhe kuvendit për punën e vet.

Neni 9

Zyrtarët dhe Nëpunësit (Sekretariati)

- 8.1. Në rast nevoje Kryesia do të emërojë Zyrtarë ose të pranojë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre duhet të caktohet nga Kryesia, për të cilat Kuvendi i Anëtarëve duhet të vendosë me shumicë votash.
- 8.2. Zyrtarët duhet të punësohen përmes marrëveshjes së shkruar e cila detalizon të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhen Zyrtarit. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe të paguhen vetëm punët e kryera për organizatë.
- 8.3. Kryesues i këtyre zyrtarëve do të jetë Sekretari i Përgjithshëm, i cili do të jetë i autorizuar t'i kryej të gjitha detyrat që i parasheh statuti i organizatës dhe vendimet e kryesisë.
- 8.4. Çështjet tjera të funksionimit të Sekretariatit rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 9

Shpërbërja e organizatës

- 9.1. Organizata mund të shpërbëhet me propozimin e kryesisë, apo dy të tretave të anëtarëve të organizatës dhe me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve me 2/3 e votave të anëtarëve prezent apo të përfaqësuar. Propozimi për shpërbërje duhet të bëhet së paku 3 (tre) muaj para datës së Kuvendit të Anëtarëve.
- 9.2. Kur të vendos për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi i Anëtarëve do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse organizata.

Neni 10
Ndryshimet e statutit

- 10.1. Statuti i tanishëm mund të ndryshohet me propozimin e kryesisë, apo dy të tretave të anëtarëve dhe me vendimin e Kuvendit të Anëtarëve me 2/3 e votave të anëtarëve prezent apo të përfaqësuar. Propozimi për ndryshimet e statutit duhet të bëhet së paku 1 (një) muaj para datës së Kuvendit të Anëtarëve.

Neni 11
Periudhat e Raportimit dhe Viti Financiar

- 11.1. Kryetari, Kryesia dhe Sekretari i Përgjithshëm do të paraqesin raporte vjetore para Kuvendit të Anëtarëve, MPV ose kurdoherë që kërkohet nga një MPJ.
- 11.2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik.

Neni 12
Dispozitat e përgjithshme

- 12.1. Çështjet që nuk janë rregulluar në nenet e këtij Statuti, duhet të rregullohen në pajtim me Ligjin numër 04/L-57 Për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare dhe ligjet tjera në fuqi në Republikën e Kosovës.

Data: 06.06.2012

Themeluesit:

Kryetari i forumit:

Lirak Çelaj : _____

Florent Mehmeti: _____

Eroll Shporta: _____

Hajrulla Çeko: _____